

**UNIVERSITETI I PRISHTINËS**  
**"HASAN PRISHTINA"**  
**FAKULTETI I BUJQËSISË DHE VETERINARISË**



**Potenciali prodhues i gjenotipeve të grurit (*Triticum aestivum* L.) të  
hulumtuara në kushtet agroekologjike vendore  
(Punim diplome)**

**MENTORI:**  
**Prof. Asoc. Dr. Dukagjin ZEKA**

**Studentja:**  
**BSc. Dorentina KRASNIQI**

**Prishtinë, 2023**

**UNIVERSITETI I PRISHTINËS**  
**"HASAN PRISHTINA"**  
**FAKULTETI I BUJQËSISË DHE VETERINARISË**

**PUNIM DIPLOME**

**Potenciali prodhues i gjenotipeve të grurit (*Triticum aestivum* L.) të hulumtuara në kushtet agroekologjike vendore**

**Production potential of wheat genotypes (*Triticum aestivum* L.) in local agroecological condition**

*Studenti:*

*Emri dhe mbiemrit i studentit: Dorentina Krasniqi*

*Satusi i studentit: Rregullt*

*Numri i amzës:*

*Programi: Lavërtari Perimtari*

*Shkalla e studimit: Master*

*Mentori: Prof. Asoc. Dr. Dukagin Zeka*

## ABSTRAKTI

Nga kulturat bujqësore të cilat kultivohen në përmasa të mëdha dhe kanë përhapje të gjerë janë drithërat që kultivohen në të gjithë botën. Ndër drithërat të cilat konsiderohen si më të rëndësishme në aspektin bujqësor është gruri. Gruri, konsiderohet si kulturë esenciale për jetë sepse është i vetmi drithë i përshtatshëm për prodhimin e bukës së thartë që përdoret për ushqimin e njerëzve, duke ofruar kështu materjet kryesore të nevojshme për organizmin e njeriut. Pra, rëndësia e tij ushqyese si për njerëz edhe për kafshë e bëjnë grurin të jetë edhe si kulturë strategjike sidomos në raste të krizave.

Gruri (*Triticum aestivum* L.) është kulturë një vjeçare e cila në sistematiken botanike sistemohet në familjen Poacea (*Gramine*) e gjinisë Triticum që i përket grupit heksaploid ( $2n=42$  kromozome). Gruri hynë në grupin e drithërave i cili me sukses kultivohet në zonat me klimë dhe nivele të ndryshme mbidetare, duke filluar nga klima mesatare, humide dhe aride, nga temperatura e nxehta, mesatare e deri te ato të ftohta. Gruri si një nga kokrrat kryesore të drithërave prodhohet dhe konsumohet në nivel global. Rritet në sipërfaqe të mëdha se çdo kultur tjetër tregtare dhe vazhdon të jetë drithëri më i rëndësishëm në kuadër të burimit të ushqimit për konsum njerëzor. Prodhimi botëror i grurit është i ranguar i treti për nga pasha e prodhuar, pas misrit dhe orizit. Qëllimi i hulumtimit ishte vlerësimi i Potencialit prodhues i gjenotipeve të grurit (*Triticum aestivum* L.) të hulumtuara në kushtet agroekologjike vendore, duke u bazuar në parametra fushor dhe laboratorik. Për këtë qëllim u shfrytëzuan fushat eksperimentale në dy regjione të ndryshme agroklimatike të Republikës së Kosovës, në Rrafshin e Dukagjinit në Vitomericë – Pejë, dhe në Rrafshin e Kosovës në Lipjan.

Dizajni i ngastrave eksperimentale (NE) ishte sipas bllokut të randomizuar (RCBD) me tre përsëritje. Edhe pse gjepetnoti ishin mbjell dhe kultivuar në kushte të njëjta agroekologjike, shfaqen variabilitet gjenetik për parametrat e hulumtuar, për shkak të origjinës së ndryshme. Dallimet statistikore për parametrat e hulumtuar ishin larte sinjifikante për nivelin e probabilitetit  $p \leq 0.01$  dhe  $p \leq 0.05$ .

## ABSTRACT

Among the agricultural crops that are cultivated on a large scale and have a wide distribution are grains that are cultivated all over the world. Among the grains which are considered the most important in terms of agriculture is wheat.

Wheat is considered an essential crop for life because it is the only grain suitable for the production of sourdough bread that is used for human nutrition, thus providing the main materials necessary for the human body.

So, the importance is both for people and for those who make wheat a strategic crop, especially in times of crisis. Wheat (*Triticum aestivum* L.) is an annual crop which in botanical systems it is classified in the family Poacea (Gramine) of the genus *Triticum* which belongs to the same hexaploid group ( $2n=42$  chromosomes).

Wheat entered the group of grains and which is successfully cultivated in areas with different climates and altitudes, starting from the average, humid climate and arid, from hot, medium to cold temperatures. Wheat as one of the main grain and is produced and consumed globally. It grows larger than any other commercial crop and continues to be the largest grain in terms of food source for human consumption. All wheat is ranked third by weight of production, after corn and wheat.

The purpose of the research was to evaluate the productive potential of wheat genotypes (*Triticum aestivum* L.) investigated in local agroecological conditions, based on field and laboratory parameters. For this purpose, experimental fields were used in two different agro-climatic regions of the Republic of Kosovo, in the Dukagjin Plain in Vitomerica- Pejë, and in the Kosovo Plain in Lipljan.

The design of experimental plots (EP) was randomized complete block design (RCBD) with three replications. Even though the genotypes were planted and cultivated under same agro-ecological conditions showed different genetic variability for investigated parameters, because they were with different origins. Statistical differences for evaluated parameters were higher significantly for level of probability  $p \leq 0.01$  and  $p \leq 0.05$ .